

Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa për studentët dhe stafin akademik të Universitetit të Tiranës, në Universitetin Masaryk në Republikën Çeke

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Masaryk në Republikën Çeke.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (5 muaj);
- Master (5 muaj);
- PhD (5 muaj)
- Staf akademik për mësimdhënie (7 ditë)

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Masaryk klikoni në adresën:

<http://cic.muni.cz/en/left-incoming-mobility/incoming-student/courses-for-international-students>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e nevojshme për aplikim:

I gjithë aplikimi është online.

Linku i aplikimeve: <https://isois.ois.muni.cz/public/application-incoming/>

Për më shumë informacion lidhur me guidën studentore klikoni linkun e mëposhtëm: <https://czs.muni.cz/en/student-from-abroad/international-student-guide>

Hapat për plotësimin e formularit janë si më poshtë:

Hapi 1 i aplikimit:

- Klikoni në linkun e formularit të aplikimit:
<https://isois.ois.muni.cz/public/application-incoming>
- Tek fusha “ Cycle” zgjidhni opsionin “Erasmus+ (outside Europe)
- Fushën “Level of study/cooperation” zgjidhni llojin e mobilitetit që do të aplikoni “Master”
- Në fushen “Country: zgjidhni opsionin “Albania”
- Në fushën e “Partner Institution” do të zgjidhni “University of Tirana”
- Ne fushën e fundit “Agreement through which to apply” do të zgjidhni të vetmën mundësi që shfaqet, “University of Tirana (2017-19)” duke e klikuar atë
- Pas kësaj klikoni në butonin “Create new application”.

Hapi 2: Plotësoni formularin me të dhenat tuaja dhe ngarkoni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Foto personale në përmasat e pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Listë notash(në gjuhën angleze);
- CV(në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj*
- Temën e kërkimit (vetëm për aplikantët PhD)
- Letër pranimi paparak nga Universiteti Masaryk (vetëm për studentët PhD dhe stafin)

* **Mbi certifikatën e gjuhës së huaj:** Niveli minimal i kërkuar për njohjen e gjuhës angleze nga aplikantët është B2. Certifikatat e njohura prej tyre mund t'i gjeni këtu: <http://bit.ly/1ljbOvR>

Afati për aplikim: **31 Janar 2018**

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!